



Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-125
Datë: 27.02.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 16.02.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet **"PROED SH.P.K"** në Prishtinë, për periudhën **28.02.2017** deri **28.02.2020** për të ofruar kualifikime të validuara në KKK:
 - 1.1. **Zhvillues Softueri; Niveli V sipas KKK,**
2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:
 - 2.1 Të vendoset kutia e ankesave/sugjerimeve në një hapësirë jo të vëzhguar nga kamerat.
 - 2.2 Të ofrohen ekzemplarë të testeve të rregullta dhe të projekteve finale për të gjitha lëndët.
 - 2.3 Të ofrohen ekzemplarë të paketave mësimore (literaturës bazë mësimore)
 - 2.4 Të definohet koha e arkivimit të provimeve, testeve, ushtrimeve dhe materialeve të rëndësishme si dhe procedurat dhe organizimin e kopjeve rezervë për të dhënat elektronike.
 - 2.5 Të bëhet sinjalizimi duke e shtuar planin e evakuimit në secilën hapësirë të brendshme.
 - 2.6 Të lidhen marrëveshje për partneritet me bizneset në të cilat do të organizohet puna praktike e studentëve (internship).

- 2.7 Të planifikohet buxheti vjetor i ndarë për zhvillim të stafit dhe politikat të cilat do të ndiqen për zhvillim dhe avancim të stafit.
 - 2.8 Të zhvillohet dhe të aprovohet procedurë për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta.
 - 2.9 Të krijohet lista e softuerëve, aplikacioneve, licencave dhe veglave tjera që kanë nevojë për mirëmbajtje dhe luajnë rol në punën e përditshme të shkollës.
 - 2.10 Në kuadër të hapësirave të shkollës të realizohet një hapësirë e mësimdhënësve.
 - 2.11 Stafit akademik (profesorët) të pajisen me adresa të e-Postës me domenin PROED-KS.com për komunikim zyrtar.
 - 2.12 Të zhvillohet procedura për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe ndarjes së fitimit të mundshëm nga prodhimtaria që mund të lidhet me autori dhe pronësi intelektuale.
 - 2.13 Të realizohet intraneti dhe funksionalizimi i platformës MOODLE, meqenëse shkolla është zotuar se shpërndarja e materialeve të dhe mësimi në distancë do të bëhet përmes intranetit.
 - 2.14 Në syllabuse të pasqyrohet edhe përqindja dhe numri i orëve për vetë studim si dhe të përcaktohen metodat e vlerësimit.
 - 2.15 Meqenëse shkolla është një startup dhe në bazë të planit të biznesit funksionimi i shkollës varet nga të hyrat e studentëve, duhet të ofrohet një sigurinë financiare.
3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën **01.09.2017**, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:

- "PROED SH.P.K";

- AKK.



Bedri Xhafa

Nënkryetari i KD së AKK-së